



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 25 datë 10.5.2022

**“PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE
ME QIRA PRANË QENDRËS KOMUNITARE “PËR FAMILJEN” NR. 6 DHE
BANESAT SOCIALE ME QIRA PËR KOMUNITETIN ROM PËR VITIN 2022”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 10.05.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; nenit 30 pika 2, të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”; pika 11, 13 e VKM nr.522 datë 25.07.2019 “Metodika e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira”, VKB nr.1 datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore”, i ndryshuar; VKB nr.30 datë 03.06.2021 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6 për vitin 2021”, VKB nr.31, datë 03.06.2021 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom”, e-mail i datës 04.03.2022 i Institutit të Statistikave INSTAT mbi “Ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të konsumit” si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6, për vitin 2022 si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit A me sipërfaqe 56.8 m² (3316 x 2% = **3,382 Lekë/Muaj**).

Qiraja mujore e apartamentit B me sipërfaqe 88.9 m² (5191 x 2% = **5,295 Lekë/Muaj**).

Qiraja mujore e apartamentit C me sipërfaqe 96.1 m² (5611 x 2% = 5,723 Lekë/Muaj).

2. Miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom për vitin 2022, si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit 1+1 me sipërfaqe 30 m² (1,900 x 2% = 1,938 Lekë/Muaj).

Qiraja mujore e apartamentit 2+1 me sipërfaqe 40 m² (2,500 x 2% = 2,550 Lekë/Muaj).

3. Të ardhurat e mbledhura nga qiratë nga e fondit publik të banesave sociale me qira do të derdhen në llogarinë ekonomike të Bashkisë Shkodër me kodin nr. 7109600 me emërtimin “Qira e ndërtesës” (nga banesat sociale me qira).
4. Të ardhurat e depozituar nga qiratë e banesave sociale me qira përdoren nga strukturat përgjegjëse të administrimit të banesave sociale me qira për mirëmbajtjen dhe administrimin e tyre dhe raportohet mbi përdorimin e fondit si pjesë e programit buxhetor nr. Programi 10661, Strehimi Social.
5. Niveli i qirasë i përcaktuar në pikat 1 dhe 2 është i vlefshëm deri me 31.01.2023.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR


Brisela KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 29 vota

Vota Pro 29

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 12.5.2022